Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br. 69/17, 72/17, 73/17
Datë/Datum 27.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Gjakovë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesat me Nr. **69/17, 72/17 dhe 73/17.**		
Datë:	27.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 08.03.2017 me Nr. **69/17** nga OE **"Marisa&Benita"** - Gjakovë, ankesën e parashtruar me dt: 10.03.2017 me Nr. **72/17** nga OE **"Berisha&Eko Drinia"** – Gjakovë, ankesën e parashtruar me dt: 13.03.2017 me Nr. **73/17** nga OE **"Er-Lis&Ve-Mor"** – Pejë, për shqyrtimin e lëndës: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjakovë**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA GJAKOVË.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **MARISA&BENITA, BERISHA&EKO DRINIA, ER-LIS&VE-MOR**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		15.03.2017		**15.03.2017**		**27.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 08.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **69/17** e parashtruar nga OE **"Marisa&Benita"**, me seli në Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjakovë**.

Me datën 10.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **72/17** e parashtruar nga OE **"Berisha&Eko Drinia"**, me seli në Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjakovë**.

Me datën 13.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **73/17** e parashtruar nga OE **"Er-Lis&Ve-Mor"**, me seli në Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjakovë**.

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Gjakovës (KGJ).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues:

Pikat e Ankesës nga OE **"Marisa&Benita"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 72 - Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne si konzorcium kemi plotesuar te gjitha kerkesat e parashtruara ne dosjen e tenderit perkatseisht ne FDT.

PIKA 1 e letres standard te Eliminimt: nuk qendron, pasi qe ne kerni plotesuar pjesen C perkatesisht formularin e dorzirnit si dhe kemi paraqitur ne flete te ndara shtese Edhe deklarata e kerkuar te konzorciumit dhe te njejtat jane ne foiiiie origjinale te nenshkruar dhe te vulosura nga konzorciumi.Po ashtu ne Vendimin apo perigjen me shkrim qe kemi pranuar, AK- ka dale jashte kompetencave duke aluduar se nuk eshte nenshkruar nga personi competent I kompanise private gje qe per ne, ky aludimi eshte qesharak pasi qe edhe nuk eshte ceke ne Letren standarde te elirninimit

PIKA 2 e letres standard te eiminimit;eshte e nderlidhur me piken I k¯u prap ceket e rjejta kerkese per

formimin,fuksionimin dhe pergjegjesit e gupit te operatoreve ekonomik. Deldratat per formimim , pergjegjsit, fuksionim per akivitetin e prokurinnt jane te nenshkruar dhe ne former! origjinale jane ne dosje te tenderit andaj sipas nesh Icjo e gjetur nga aria e AK-sw nuk gendron.

Pas faktimit te kundershtimit dhe ankimirnit tone kerkojme qe lend ate kthehet ne rivlersim dhe nga ana e AK-se mos te anashkalohemi dhe te shperblehemi me kontraten e merituar, ne menyre te mbrojtjes dhe kursimit te paras publike dhe mbrojtjen e Ligjit te Republikes.

Pikat e Ankesës nga OE **"Berisha&Eko Drinia"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Me dt. 30.01.2017 ne ora 14:00 eshte bere hapja e ofertave ne zyren e prokurimit KK Gjakove Më dt.24.02.2017 AK-së, KK. Gjakovë, ka bërë Njoftimin zyrtar për ; "Njoftim për Dhënjen I e Kontratës " në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Ëeb faqen KRPP për Kontratën për prokurimin "Mirëmbajtja e gjelbrimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve të drunjeve dekorativ ." me numër të prokurimit 632-16-080-211 për "Njoftim mbi dhënjën e Kontratës ",ku shpall fitues Biznesin N.T.P" BENI" me çmimin 145,802.70 euro.Me dt.24.02.201.7,kompania jonë koform kerkesave ligjore ,ka kërkuar çasje në dokumentacion ,gjatë analizës se dokumentacionit te OE,të propozuar për kontratë kem hasur shumë parregullsi.OE i shpallur fitues nga Komisioni i AK-së, nuk ka bërë plotësimin e Dosjes se Tenderit ,konform kërkesave ligjore , ku në ANEKSIN 3 tek pjesa e operatorit ekonomik nuk është i plotësuar me emerin e biznesit dhe as pjesa që për çfare informata konfidenciale ka nevoje Biznesi, ndërsa tek Aneksi 5, është shenuar emri i biznesit , mirpo nuk është e plotësuar pjesa për informacione shtesë. OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar pjesën B, kërkesave ligjore ,tek pjesa e Biznesit nuk është e vulosur, nënshkruar . OE i shpallur fitues NUK ka plotësuar pjesën V të kontratës ,tek pjesa e Biznesit nuk është plotësuar pra mungon nënshkrimi dhe vula. OE i shpallur fitues NUK ka plotësuar pjesën C Formulari i Dorëzimit të Tenderit ,NUK është i plotësuar konform kërkesave ligjore ,pra vetëm është vulosur por pa nënshkrim gjithashtu edhe nacionaliteti NUK është i plotësuar dhe validiteti i tenderit nuk është konform kërkesës së tenderit.OE i shpalur fitues nuk ka plotësuar dhe nënshkruar komplet paramasën dhe parallogarin, por vetëm fletën e fundit,Gjithashtu paramasa dhe parllogaria , e operatorit ekonomik i cili është shpallur fitues nga Komisioni i AK-së, në të gjitha pozicionet është e llogaritur gabim, dhe duhet të shpallet si pa përgjegjëshme , sepse nuk i përmbush kriteret dhe kërkesat e Ligjore.Po e Ri -theksojm se e gjithë Paramasa dhe Parallogaria është e llogaritur GABIM,sipas kësaj llogaritje vlera e ketij tenderi të ketij OE i cili është propozuar për Kontratë është =139, 171.55 euro me TVSH ,ndersa Biznesi ka ofertuar me çmim prej 145,802.70 euro me TVSH, Diferenca e kalkuluar ma shumë është 6,631.15 euro ,pra kjo diferencë është gabim material ,që është 5 % dhe është mbi limitet e lejuara të legjislacionit që lejohet gabim deri në 2 % te vlerës.Prandaj Komisioni rreth këtij vlersimi ka bërë vlerësim të gabuar ,sepse propozon për kontratë ,OE "BENI " , ku e gjithë paramasa dhe parallogari është e plotësuar gabim, pra komisioni fare nuk është marrë me verifikimin e Paramasës dhe Parallogarisë ,për të evidentuar ketë Gabim Material, për faktin se ne i kemi kërkuar AK-së gjatë qasjes kopje fizike të paramasës dhe parallogarisë të cilat i kemi egzaminuar nje për një të gjitha pozicioniet dhe rezulton siq edhe e permendëm më lartë se

Çmimi Total i Ofertës është 139, 171.55 euro , që do të thotë se është mbi 2 % e lejuar në dispozitat e nenit 59 te LPP-S8.Raporti i Komisionit rreth Vlerësimit të Tenderëve i dt. 02.02.2017 në përbërje prej :Lekë Sina -Kryesues , Besim Shllagu -Anëtar dhe Dafina Thaqi -Anëtar ,ne raportin e dt. 02.02.2017 ,ne fq.3 të Raportit shifet se neve si oe "berisha company "dhe "eko drini ,tek pjesa tenderi i përgjegjëshëm me kerkesat e pranueshmerisë dhe përshtatshmërisë profesionale po/jo , neve si OE na kanë shapllur të përgjegjëshem dhe që e plotësojm këtë kriter ,në anën tjetër po nga ky Komision për të njejtin kriter NE si OE eliminoheni si të pa përgjegjëshëm.Tek Raporti i Komisionit në fq.4 ,dhe ne Letrën Standarde për Tenderuesin e Eleminuar ,pjesa e stafit ku inxhinieri i Bujqësisë nuk është marrurë i pranueshëm për kriterin e stafit.Lidhur me këtë arsye të eliminimit ne kem ofruar diplomën e inxhinierit të Bujqësisë sipas kërkesës së dosjës së tenderit , ku është kërkuar inxhinieri i bujqësisë dhe në asnjë rresht të kësaj kërkese nuk kërkohet apo nuk përmendet se çfarë titulli apo grade duhet te ketë inxhinieri i bujqësisë . Në rastin konkret ne kemi ofruar diplomen e inxhinierit të bujqësisë.Për këtë pikë ne kem dëshmi se OSHP - ,ka pasur kërkesë zyrtare nga Universiteti i Prishtinës se a është i njejtë Bachelor i Diplomuar me inxhinierin e Diplomuar , dhe për këtë ka marrurë përgjegjje pozitive nga Univeristeti i Prishtinës (shif ARKIVENE OSHPSE VENDIM nr.346/11,353/11 dhe 354/11 , te dt.25.11.2011 ,MB projektin Klinë Brojë , investitor : M , viti 2011),dhe për ketë pikë pretendimet e Mi-se në këtë rast se Defrim Kabashi si Bachelor i ndertimtarisë NUK e plotëson kriterin janë HUDHUR POSHTE , nga OSHP.Konform ketij vendimi të OSHP-së, Raporti i Komisionit KK. Gjakovë i dt. 02.02.2017 është i papranueshem dhe në kundershtim me vendimin e oshp-se, për këtë kriter.Ne letren standarde AK-ja deklaron se nuk i kemi plotësuar kërkesat e FDT -së (sepse është përdorur formulari standard, Pjesa II, Lista e Çmimeve).Kjo arsye e eliminimit është krejtësisht e pakuptueshme për neve sepse vete AK-ja deklaron se "sepse është përdorur formulari standard, Pjesa II, Lista e Çmimeve" dhe ne dijenin tonë duhet të përdoren formularet standard të aprovuar nga KRPP-ja dhe ne lidhje me këtë pjesën C e cila lexohet në hapje të ofertave nuk ka pasur vërejtje.Sa i perket paisjes ne lidhje më cisternen e kërkuar në dosje ,ne kemi ofruar mbi 3,000.00 litra dhe me ketë vetëm sa edhe e kemi tejkaluar kërkesën e paraparë në dosjen etenderit.Duke u nisur nga natya e mirmabjtjës së rrugeve , ku me ketë rast paisja cistern sa me e madhe të jetë është edhe me efektive në pastrimin e rrugëve dhe në mbarëvajtjen e komunikacionit sepse me vetëm 3,000.00 litra mund të pastrohet një rrugë shumë e Vogël.Propozimi ynë është që ky aktivitet i prokurimit të kthehet ne RI-VLERËSIM dhe ankesa jonë të aprovohet si e bazuar sepse AK. Komuna e Gjakovës ka rekomanduar për kontratë një OE të pa-përgjegjshëm siq edhe e cekëm më lartë ku i njejti e ka tejkaluar 2 % e gabimit aritmetik dhe me ketë rast nuk është respektuar neni 60 sepse nuk rekomanduar për kontratë tenderi i përgjegjëshëm me çmimin më të ulet.

Pikat e Ankesës nga OE **"Er-Lis&Ve-Mor"** - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 61 – Tenderët jo-Normalisht te ulët;
Neni 72 - Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.
Neni 27 - I UOPP-se.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Keni kërkuar Kamion deri ne 1.5 t

- Për kamion deri ne 1.5 t, të nderuar nuk egzistojn kamion të cilët i plotësojn

këto norma, mirpo ne kemi prezentuar dëshmi të mjaftueshme se posedojm makineri deri ne 1.5 t por jo kamion por me emërtim tjetër (kamionetë,...) automjte - të cilat e përmbushin ketë kriter i cili është lëshim nga ana e juaj.

- Në LISËN E MAKINERISË së dorezuar kemi makineri adekuate sipas kerkesave

te juaja, por JO me emertim të njejë si në kerkesat e DT dhe FDT.

- Sa ju perket "kamionave" deri ne 1.5 - numri rendor 8,72,78
- Kurse per Cisternë deri ne 3000 l numri rendor 33,40 e po ashtu posedojm edhe

depozita ë ujit të të gjitha llojeve. (dëshmia 2,3)

* por - JU lutem, keni kërkuar CISTERNE e jo depozitë të ngarkuar në kamion siq ka prezentuar OE e propozuar për kontratë /?

Në pajtim me Nenin 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë të LPP-së keni mundur të vërëtoni të gjitha keqkuptimet dhe lëshimet e bëra,dhe nga të gjithë OE të kërkoni sqarime duke mos diskriminuar asnjë ofertues.

Po ashtu duke parandaluar shkeljet e dispozitave të LPP-së. Neni 61 Tenderët Jonormalisht të Ulët ku OE i propozuar për kontratë, ne mënyre manipulative ka vendosur Çmimet Jo-normalishte të Ulëta në shumë pozicione të dosjes se Tenderit. (dëshmia 4).

	Sasia	Çmimi	
6.Vendosja e kubzave te reja	M2	1500	0.82
7.Vendosja e anesoreve 8x20x100 cm	M	1450	0.82
8.Furnizimi shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit fraksion 0.31	M3	1550	0.82 etj.

Dëshmitë e dorëzuara:

1. Pjesa C, formulari i plotësuar dhe i dorëzuar së bashku me Marrveshjen mbi themelimin e Grupit, Deklaratat e anetarëve të konzorciumit dhe Autorizimi

2. Lista e makinerisë e dorezuar

3. Dëshmitë e kamion-etave, Dudi Doganor i Makinerise(cisternes) per ujitje etj.

4. Pjesa C formulari i plotësuar nga OE e propozuar për kontratë dhe lista e "Çmimeve"jo normalishtë të ulët

DEKLARATA

Në letren standarde për tenderuesin e eliminuar keni sqaruar se :

- Pjesa C nuk i plotëson kërkesat e kërkuara në FTD (sepse nuk është plotësuar pika e 7 e

pjesës C, sepse nuk janë deklaruar partnerët në Konziurcium, si dhe nuk është përdor formulari standard, pjesa II, lista e çmimeve. Sqarim: Është në kundërshtim me nenin 18.3 (të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik)

- Mungon dëshmia e posedimit të 2 kamionëve deri në 1,5 t
- Cisterna e prezantuar nuk e plotëson kërkesën në dosje së tenderit e cila është

kërkuar deri në 3000 litra, OE ka prezantuar Cisternë mbi 3000 litra.

Sqarimi 1

- Në pajtim me Neni 71 ë LPP-së, Neni 27 paragrafi 27.1 të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik. Grup i Operatorëve Ekonomik, është dorëzuar
- Marrveshja mbi themelimin e grupit, deklaratat autorizimi janë pjesët ku deklarohen anëtarët e grupit, kurse sa i perket Nenit 18.3 ë Rregullores dhe
- Udhëzuesit për Prokurim Publik ju sqaroj se kemi ploësuar formularin dhe e kemi nënshkruar (dy pjesët) nga përsoni i Autorizuar i Konsorciumit. (dëshmia 1)

Sqarimi 2

Posedojm makineri speciale per mirembajtje verore dhe aë makineri speciale ashtu siq keni kerkuar ne DT dhe FDT

Keni kërkuar CISTERNE për ujitje deri ne 3000 lit,

- Kemi paraqitur Cisërna Speciale ë cilat përdoren për ujitje, për tërheqjen e ujrave të

zeza e po ashtu edhe për depërtim. Dmth Cisërna e ka depozitën për ujë rreth 3000 lit kurse pjesen tjetër e ka për tërheqjen e ujrave ë zeza, ashtu siq e keni kerkuar ne dosjen etenderit. Cisërnat në fjalë posedojn gypin e gjatë më shume se 100 m, për ujitje, që do të thoë se është adekuaë për ujitje dhe për kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit.

- Kurse Cisërna tjeër po ashtu e ka mundësin e ndarjes të depoziës së ujit

3000,400,5000etj dhe po e njejta ka gypin rreth 100 m i cili është i paraparë për depërtim,ujitje etj.

- Po ashtu sa i perket kësaj kerkese kemi dorëzuar Dudin doganor për: Makinen

speciale për punë publike,Makineri për ujitjen e gjelbërimit, marka Rolba Tipi K3000.

P R O P O Z I M

Organit Shqyrtues të Prokurimit i prozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ER-LIS SHPK & VE-MOR SHPK për aktiviëtin e prokurimit 632-16-080-211 me titull: Mirëmbajtja e gjelbërimit të qyëtit dhe mbjellja e fidanëve të drunjve dekorativë nxjerrë

VENDIM:

I. APROVOJË - si të bazuar ankesen e ER-LIS SHPK & VE-MOR-shpk PEJË

II. ANULOJ vendimin - për tenderuesin e eliminuar dhe dhënjen e Kontratës

III. URDHËROJ AK Komuna e Gjakoves që aktivitetin e Prokurimit : 63216-080-211" Mirëmbajtja e gjelbërimit të qyëtit dhe mbjellja e fidanëve të drunjve dekorative" ta kthej në RI-Vleresim dhe të shpall fitues kompanin tonë pasi që i plotësojm të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	19.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbime/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	30.01.2016
Data e hapjes së ofertave	30.01.2016-14:00^{h}
Kriter për dhënie të kontratës:	*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*
Lloji i kontratës:	*Kontratë kornize – 36 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

- OperatoriEkonomikduhettipërmbushëkërkesat e specifikuaranënenin 65 tëLigjittëProkurimitPublik (LPP).
- Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- Vërtetim nga Gjykata kompetente.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
- Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).
- Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

- Regjistrimisi Operator Ekonomiknëregjistrinprofesional, komercialdhe/aporegjistrin e ndërmarrjevenëvendin e juajtëthemelimit
- Certifikata e Numrit Fiskal
- Certifikata per Regjistrimnë TVSH e lëshuarnga ATK
- Licenca nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).
- Certifikata e numrit fiskal (kopje).
- Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).
- Licenca nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (kopje)

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar

- Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme prejsë paku 450,000.00€, në tre vitet e fundit (2013,2014,2015).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

-Vërtetimi nga banka ose raport bankari nënshkruar dhe vulosur i cili dëshmon se qarkullimi bankar i kërkuar në periudhën e tri viteve të fundit është i plotësuar sipas kërkesës.

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

- OperatoriEkonomikduhettëofrojëdëshmi se kapërfunduar me sukseskontratatenatyrës se ngjajshmenë 3 (tri)vitet e fundit (sëpakunjë).
- OperatoriEkonomikduhettëofrojëdëshmi se kaosemundtëangazhojstaftëmjaftueshëmpërkryerjene projektit ,siqështënjë inxhinier i diplomuar i bujqësisë dhe sëpaku 4 punëtorë.
- Operatori Ekonomik duhet tëofrojëdëshmi se kanë dispozicion mjete-paisje teknike për realizimin e kontratës siq janë:

a.) 2 kamiona deri 1,5 t,
b.) 1 cisternderi 3000 l,
c.) 3 makina për prerjen e barit,

Dëshmia e kërkuardokumentare

- Listën me referenca në të cilën specifikohen të gjitha aktivitetet e shërbimit të Operatorit Ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar shërbimet e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit - (së paku një e cila përputhet kontrata me referencë ose raport pranimit)
- Listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore duke e dëshmuar me diploma dhe kontrata të punës. Nëse anëtarët e stafit nuk janë në marrëdhënie pune te Operatori Ekonomik, atëherë duhet dorëzuar kontratën për projektin në fjalë (të dëshmohet me një Deklaratë që Operatori Ekonomik i ka të punësuar ose mund ti angazhoj staf për kryerjen e punëve me sukses,e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik)
- Listën e mjetet-paisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre , ose DUD – i doganor ose kontrata mbi qiramarrjen e vërtetuar nga Operatori Ekonomik.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Er-lis&Ve-Mor"		242,989.08€	JO
2.	"Berisha Company"		144,076.75€	JO
3.	"Marisa"		114,200.89€	JO
4.	"Al-Ing"		134,968.75€	JO
5.	"Beni"		145,802.70€	JO
6.	"Victory Com"		65,485.53€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Lek Sina - Kryetar i komisionit
- Besim Shllaku - Anëtar i komisionit
- Dafina Thaqi - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 21.02.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....21.02.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....24.02.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	Beni	145,802.70€	1

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni i vlerësimit pas shikimit te dokumentacionit te OE "Beni", konstatoi se i plotëson te gjitha kërkesat e kërkuara ne dosje te tenderit dhe e propozon me nënshkrim te kontratës.

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letrën standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE ankues konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, ja refuzon ankesën si të pa bazuar.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues "Marisa", eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se ne piken 7 te formularit te tenderit nuk i ka paraqitur – deklaruar anetaret e konzorciumit. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ne formularin e tenderit nuk i ka paraqitur anetaret e konzorciumit, mirëpo ata kan nje deklarat te themelimit te konzorciumit te nënshkruar dhe vulosur. Ne lidhje me marrëveshjen e konzorciumit e cila eshte edhe arsye tjeter e eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se konzorciumit "Marisa&Benita&Horn Co", i mungojn deklaratat tjera sipas nenit 71 te LPP-se, prandaj, eksperti shqyrtues sqaron se me te drejt e ka eliminuar AK-ja.

Sa i perket arsyetimit te AK-se, ne lidhje me deklaratat nen betim, eksperti shqyrtues, sqaron se deklaratat nene betim i kan ofruar te tre anetaret e konzorciumit, prandaj, eshte i paqendrueshem ky arsyetim i AK-se.
Lidhur me deshmit e makinerise per projektin ne fjal eksperti shqyrtues, sqaron se eshte i qendrueshem arsyetimi i AK-se, per faktin se OE ankues nuk ka ofruar deshmi per pajisjet e kërkuara per realizimin e projektit. Poashtu ne lidhje me deshmit per kontrata dhe referenca per sherbime te ngjashme, OE ankues nuk ka ofruar deshmi sipas kerkeses se dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrat.

Ndersa sa i perket arsyetimit te AK-se, ne lidhje me formularin e paramasës dhe parallogarise se OE ankues nuk e ka perdor formularin standard, eksperti shqyrtues sqaron se eshte i paqendrueshem ky arsyetim per faktin se cmimet jane dhene sipas dosjes se publikuar nga AK-ja.

Sqarimi nr.2

Sa i perket arsyes se eliminimit ne lidhje me mospërdorimin e formularit standard te parallogarise dhe paramasës te OE ankues "Berisha", eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues i ka dhene cmimet sipas kerkesave te AK-se.

Ne lidhje me inxhinierin e bujqesise, e cila eshte nje nder arsyet e eliminimit, eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, ka kërkuar inxhinier te diplomuar te bujqesise. OE ankues ne oferten e tij ka ofruar inxhinierin e bujqesise – Bachelor, drejtimi i Pemtarise. Eksperti shqyrtues, vlereson se sipas kerkeses OE ankues e ka plotësuar minimumin e kerkeses se dosjes se tenderit prandaj, mendon se eshte i paqendrueshem eliminimi ne lidhje me kete diplom.
Eksperti shqyrtues, ne lidhje me deklaratat e konzorciumit sqaron se ne oferten origjinale OE ankues i ka ofruar deklarat e themelimit te konzorciumit sipas nenit 71 te LPP-se, prandaj, eshte i paqendrueshem ky arsyetim i eliminimit.
Ne lidhje me cisternen e kërkuar nga AK-ja, ne dosje te tenderit, ku AK-ja, ka kërkuar qe cisterna te jet me kapacitet deri ne 3000 litra, OE ankues ne oferten e tij e ka ofruar mbi 3000 litra, eksperti shqyrtues lidhur me kete sqaron se OE ankues e ka plotësuar kete kerkeses mirëpo tejkalimi i saj me kapacitet me te madh se 3000 litra uje, eksperti shqyrtues vlerëson se fakti qe e ka plotësuar nuk paraqet ne realizimin e projektit, megjithatë i mbetet AK-se, qe gjate rivlerësimit te sqaroj se ku jane efektet negative per realizimin e këtij projekti nese kjo ciste reshte me kapacitet me te madh.
Sai perket pretendimit te OE ankues se OE i rekomanduar per kontrat nuk e ka ofruar validitetin sipas kerkeses eksperti shqyrtues sqaron eshte i paqendrueshem per faktin se OE i rekomanduar per kontrat e ka ofruar sipas kerkeses.

Sqarimi nr.3
Sa i perket ofertes se OE ankues dhe arsyeve te eliminimit te ofertes se tij nga ana e AK-se, eksperti shqyrtues sqaron se deklaratat e konzorciumit OE ankues "Er Lis&Ve Mor", i ka ofruar ne oferten e tij prandaj, kjo arsye e eliminimit është paqëndrueshme. Mosdeklarimi ne formular te tenderit te anetareve te konzorciumit mund te konsiderohet devijimi i vogel per faktin se OE-te te cilet e kane themeluar konzorciumin kan themeluar nje deklarat te vulosur dhe nënshkruar ne mes veti.

Ne lidhje me deshmit per kamionat 1.5t, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues i ka ofruar me te mëdhenj se sa kërkesa e AK-se ne dosje te tenderit dhe te njoftimit per kontrat. Ndersa ne lidhje me cisternen e cila poashtu edhe te OE ankeuse "Er lis" eshte arsye e eliminimit, eksperti shqyrtues e ka sqaruar me lart.

Lidhur me pretendimin e Oe ankues se AK-ja, ka rekomanduar per kontrat nje operator ekonomik, i cili ka ofruar cmime Jo-Normalisht te uleta eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, nuk ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar per kontrat per faktin se nuk ka dyshuuar ne cmimet e ofruara nga OE i rekomanduar per kontrat.
Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues "Er Lis", sipas tabeles se hapjes publike te ofetave eshte me cmim me te shtrejt (i fundit ne tabel) dhe se ne ankesen e parashtruar ne OSHP, nuk e ka atakuar asnje operator ekonomik përpos te rekomanduarit per kontrat, prandaj ne ankesen e tij nuk ka dëshmuar interes juridik e material konform nenit 4.1.26 te LPP-se.

Sqarimi nr.4
Eksperti shqyrtues, vlerëson se ky aktivitet i prokurimit duhet te rivlerësohet per faktin se eshte i qëndrueshëm pretendimi se OE i rekomanduar për kontratë ka gabime aritmetike ne oferten e tij ne totalin e çmimeve per njesi ku faqen e pare te parallogarise dhe parameses ne pozicionin nr 1 ka dhene çmimin prej 10 euro, e qe ne fakt sipas sasisë, çmimit te ofruar dhe çmimit te TVSH-se, rezulton te jet 9.67 euro, pastaj ne pozicionin nr 2 ka dhënë cmim prej 2,160.00 euro, e qe ne fakt duhet te jet 2,090.01. eksperti shqyrtues, lidhur me gabimet aritmetike sqaron se përveç dy pozicioneve te lartpërmendura ka pothuajse ne cdo faqe te parallogarisë dhe paramasës, andaj duke u bazuar nga ky fakt eksperti shqyrtues, propozon qe edhe oferta e OE te rekomanduar për kontratë te ekzaminohet ne lidhje me gabimet aritmetike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Gjakovë**, për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit dhe mbjellja e fidaneve të drunjve dekorativ"**, me numër të prokurimit: 632/16/080/211, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të **Rivlerësohet,** ndërsa ankesat e OE-ve ankues te aprovohet si pjesërisht te bazuara.